

# INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET



## **NË KËTË NUMËR** SPECIAL

Mbi rolin e takimeve llogaridhënëse të “trekëndëshit” polici-bashki-prokurori në parandalimin e krimit dhe sigurinë publike

Marrëveshje bashkëpunimi Për mbajtjen e takimeve llogaridhënëse  
Për parandalimin e krimit Në nivel vendor



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 5

**Integritet  
Llogaridhënie  
Partneritet**

Janar 2020

**Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:**

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Redion Qirjazi, Kontribues

Armela Xhaho, Kontribuese

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org) ose tel: 042400241

**Shënim:**

*Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimin i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.*

# MBI ROLIN E TAKIMEVE LLOGARIDHËNËSE TË "TREKËNDËSHIT"<sup>1</sup> POLICI-BASHKI-PROKURORI NË PARANDALIMIN E KRIMIT DHE SIGURINË PUBLIKE

SOTIRAQ HRONI<sup>2</sup>

GUSHT 2019

## PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

“*Dokumenti i politikave synon të promovojë një përvojë “të munguar” në bashkëpunimin e policisë, prokurorisë dhe qeverisjes vendore në parandalimin e krimit në Shqipëri. Njëherazi, dokumenti nxit një reflektim mbi praktikën e policimit parandalues dhe legjislativin që ka shoqëruar bashkëpunimin institucional në nivel vendor.*”

Mbajtja periodike e takimeve llogaridhëse përmirëson zbatimin e ligjit në nivel vendor, rrit komunikimin e institucioneve me qytetarin, rrit besueshmërinë e publikut si dhe përmirëson përgjegjshmërinë e institucioneve. Po ashtu, procesi i forcimit të llogaridhënies ndihmon në ndërtimin e partneriteteve horizontale të Policisë

së Shtetit me qytetarët dhe lehtëson ndjeshëm bashkëpunimin e Policisë së Shtetit me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Takimet llogaridhëse ndikojnë në operacionalizimin e objektivave të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe jetësimin e Strategjive Vendorë të Policimit në Qark si instrumente në përgjigje të sfidave të sigurisë që hasin qytetarët. Dokumenti argumenton se kjo praktikë, që ka marrë një mbështetje mjaft të gjerë, mund të shndërrohet në “bërës të ndryshimit” për sa i përket cilësisë së zbatimit të policimit në komunitet, që është edhe një nga objektivat kryesorë të Policisë së Shtetit.

Dokumenti evidenton se pjesëmarrja e prokurorisë i jep besueshmëri procesit të komunikimit publik dhe ndihmon në parandalimin e krimit. Vizioni i Policisë së Shtetit dhe i Prokurorisë së Përgjithshme përshkruhet në strategjitë përkatëse të këtyre institucioneve, por që kanë



- 1 Një "trekëndësh" i autoriteteve lokale është një organ këshillues që përbëhet nga Kryetari i Bashkisë, Prokuroria dhe Shefi i Komisarariatit të Policisë në Hollandë. Qëllimi kryesor është trajtimi i krimit dhe çështjeve të sigurisë publike në mënyrë më efektive, "trekëndëshi" zhvillon takime të rregullta konsultimesh për çështje të sigurisë në nivelin lokal. Nisma e tanishme e organizimit të takimeve "trekëndëshe" në bashkitë Shqiptare është një iniciativë për të përmirësuar llogaridhënjen dhe transparencën bazuar në përvojën pozitive Hollandeze. Projekti mbështetet me një grant nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.
- 2 Pikëpamjet ose opinionet e shprehura në këtë artikull janë ato të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet ose mendimet e Qeverisë së Hollandës.

nevojë për përmirësime rregullatore në lidhje me bashkëpunimet, partneritetet dhe llogaridhënien publike. Praktika e llogaridhënies për parandalimin e krimit paraqitet si një risi që meriton mbështetje politike dhe operacionale të institucioneve qendrore dhe vendore.

## ANALIZA E KONTEKSTIT

Gjatë dekadës së fundit policimi në komunitet po zë vend të rëndësishëm gjithmonë e më tepër në debatin publik për rendin dhe sigurinë publike. Në Strategjinë e Rendit Publik 2015-2020 kërkohet që filozofia e policimit në komunitet të shtrihet në të gjithë veprimtarinë e organizatës së policisë. Ligji për Policinë e Shtetit parashikon hartimin dhe zbatimin e një Strategjie Vendore të Policimit në Qarqe (SVPO). Koncepti duket tërheqës edhe për drejtuesit më të lartë politikë të vendit, të cilët janë duke e theksuar përherë e më shumë çështjen e policimit në komunitet dhe vazhdimisht u bëjnë thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë me policinë.

Një sërë nismash të ndryshme kanë dhënë ndihmesën e tyre duke ndërtuar një mozaik raportesh bashkëpunimi dhe marrëdhëniesh në nivel vendor. Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal i Shteteve të Bashkuara (ICITAP) është investuar, krahas të tjerash, në ngritjen e kapaciteteve të strukturave vendore të policisë për të bashkëpunuar me shkollat në procesin edukativ. Shumë nisma të tjera vendase dhe të huaja, si programi suedez “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri” (SCPA) janë orientuar drejt sensibilizimit të bashkëpunimit të policisë dhe institucioneve në nivel vendor, në mënyrë

të veçantë ato arsimore. Shoqëria civile dhe grupet e ndryshme vendore janë pjesë e këtyre nismave. PAMECA dhe OSCE kanë gjithashtu investuar në këtë drejtim.

Praktikat më të mira në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, ndaj të cilave Policia e Shtetit po ekspozohet si në përditshmërinë e punës ashtu edhe nga trajnimet e ndryshme nga partnerët ndërkombëtarë, janë gjithashtu një qasje ndërvepruese shumë-aktoriale mjaft e vlefshme. Në këtë kuadër, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ka nxitur përmes qasjes “Shkolla si Qendër Komunitare” një bashkëpunim shumë-aktorial në mbështetje të komuniteteve të qëndrueshme, ku institucionet vendore ndajnë përgjegjësitë dhe bashkëpunojnë për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm.

Përveç nismave të mësipërme, një praktikë e re po përqafohet vitet e fundit nga bashkitë me ngritjen e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP).<sup>3</sup> Institucionalizimi i kësaj praktike është një zhvillim pozitiv, sepse angazhon drejtpërsëdrejti qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera si ato arsimore, të ndihmës dhe përkrahjes sociale, si dhe organizatat joqeveritare, në çështje të sigurisë publike. KVSP ende nuk janë shtrirë në të gjitha bashkitë e vendit, prandaj është herët për të folur për efektivitetin e kësaj strukture. Gjithsesi, nga një analizë e parë mbi përvojën rregullatore të ngritjes dhe funksionimit të KVSP duket se janë investuar shumë përpjekje për të ngritjen e KVSP-ve por është bërë shumë pak për operacionalizimin e tyre. Kjo çështje duhet të trajtohet duke qenë se përvoja e vendeve të rajonit flet për “nevojën e krijimit të një modeli efektiv dhe operacional të KVSP që të mos mbeten

• • • •

3 Urdhri i Ministrit të Brendshëm datë 5.3.2018

thjesht një strukturë formale në letër.”<sup>4</sup>

Mungesa e efektshmërisë së bashkëpunimit shumë-aktorial evidentohet edhe në një studim për Strategjitë Vjetore të Policimit në Qark (SVPQ) të 12 drejtorive të policive të qarqeve për periudhën 2009-2014. Kjo studim evidenton se “...strategjitë vendore janë të njëjta ndër vite dhe midis rajoneve, duke mos mundur t’i përshtaten kontekstit social, kulturor dhe mjedisor të zonës”.<sup>5</sup> Për më tepër, studimi nxjerr në pah se “pavarësisht se Policia e Shtetit dhe institucionet e qeverisjes vendore (IQV) kanë ndërvepruar në rrugë formale dhe jo formale, ky ndërveprim nuk ka rezultuar në angazhimin e IQV në hartimin dhe zbatimin e SVPQ si dhe në krijimin e partneriteteve”.<sup>6</sup> Në këtë kontekst, modeli i takimeve llogaridhënese për parandalimin e krimit, të realizuara gjatë muajve të fundit me pjesëmarrjen e policisë, bashkisë dhe prokurorisë, në tërësinë e tyre sjellin një vlerë të shtuar duke trajtuar mangësitë e evidentuara më sipër. Këto takime<sup>7</sup> krijojnë mundësi unike për të ndikuar nga poshtë-lart, mbështetur në sfidat dhe perceptimet e qytetarëve për sigurinë, sikundër ofrojnë një mundësi shumë të mirë për të nxitur reagimin proaktiv të të gjithë aktorëve vendorë, përfshirë edhe qytetarët.

## MJEDISI LIGJOR PËR BASHKËPUNIMIN INSTITUCIONAL NË NIVEL VENDOR

“ Sipas një studimi të IDM-së dhe IDRA-s të realizuar në vitin 2008 rezulton se ka pasur mungesë të bashkëpunimi zyrtar mes institucioneve në nivel vendor. Më konkretisht, studimi evidenton marrëdhëniet informale dhe “spontanitetin e raporteve të bashkëpunimit në nivel vendor mes institucioneve, në mënyrë të veçantë të policisë dhe pushtetit vendor”.<sup>8</sup>

Të gjithë të intervistuarit e këtij studimi, të punësuar në shumicën e institucioneve të nivelit vendor “kërkuan rregullimin ligjor, nënligjor, apo qoftë edhe me marrëveshje mirëkuptimi (bashkëpunimi) të raporteve dhe përgjegjësi të institucioneve në dobi të përmirësimit të shërbimeve vendore ndaj qytetarëve”.<sup>9</sup>

Dhjetë vite më vonë, gjatë zhvillimit të takimeve llogaridhënese, u evidentua pothuajse e njëjta problematikë e bashkëpunimit ad hoc, gjë që reflekton marrëdhëniet ndërpersonale të drejtuesve



4 Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë. “Partneritet për Komunitete të Sigurta në Serbi (Partnership for Safe Communities in Serbia)” 2014, [http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership\\_for\\_safe\\_communities.pdf](http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership_for_safe_communities.pdf)

5 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Vlerësimi i strategjisë të Policimit në Komunitet dhe i bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me Institucionet e qeverisjes vendore, 2015, fq. 5, <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/05/Policimi-n%C3%AB-komunitet-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-2007-Shqip.pdf>.

6 Po aty.

7 Takimet lidhur mbi llogaridhëjen u zhvilluan në kuadrin e Projektit “Ndërtimi i Integritetit për Përmirësimin e Performancës dhe Qëndrueshmërisë në Luftën kundër Korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri”, i mbështetur nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës.

8 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), “Drejt një bashkëveprimi të konsoliduar midis pushtetit vendor dhe institucioneve qendrore në nivel vendor”, 2008, <https://www.osfa.al/sites/default/files/botimishqip.pdf>

9 Po aty.

të institucioneve.<sup>10</sup> Për trajtimin e kësaj problematike, ndër të tjera, lind nevoja e një analize të bazës ligjore, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me vizionin strategjik të zhvillimit të institucioneve.

Ligjet e para të Policisë së Shtetit të viteve 1991 dhe 1999 kanë qartësi shumë më të madhe si për marrëdhëniet me qeverisjen vendore ashtu edhe për raportet e policisë me publikun. Kjo vihet re në disa raste në ligj. Për shembull, në Nenin 10 të Ligjit Nr. 7504, datë 30.7.1991, “Për Policinë e Rendit”, përcaktohet se “Policia e Rendit në rreth varet nga Ministri i Rendit Publik dhe nga organet lokale të pushtetit për



detyrat e ngarkuara me ligj.” Ndërsa Neni 50 shprehet se “organet lokale të pushtetit detyrohen të vënë në dispozicion të organeve të policisë së rendit mjedisë të përshtatshme për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së tyre”.

Po ashtu, edhe Ligji Nr. 8553, datë 25.11.1999, ruan karakterin unitar dhe të centralizuar të policisë, teksa përcakton se “aktet e organeve të qeverisjes vendore janë të detyrueshme për zbatim nga Policia”, dhe që “para krijimit ose shpërbërjes së njësive vepruese vendore të Policisë dhe në rastet e emërimit të drejtuesve të Policisë së qarkut apo të shefave të komisariateve, autoriteti përkatës mund të marrë mendimin



<sup>10</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2018 dhe 2019, <http://idmalbania.org/newsletter-integrity-accountability-partnership-1/>

<sup>11</sup> VKM Nr. 750, datë 16.9.2015, “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.

paraprak të organit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse. Në rast mospëlqimi nga organi vendor, autoriteti përkatës bën argumentimin profesional të vendimit të marrë.” Më pas, ligji kërkon që drejtuesi vendor i policisë të paraqesë raport vjetor para organit të zgjedhur të njësive vendore përkatëse për çështjet e rendit e të sigurisë publike.

Të gjitha këto prerogativa bashkëpunimi përbëjnë themelet për një partneritet zyrtar, të cilat mbështesin më mirë vizionin e sotshëm të Policisë së Shtetit dhe përbaljen me sfidat e qytetarëve për siguri publike.

Termi “policimi në komunitet” për herë të parë përmendet në Ligjin Nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, ku përshkruhen aktorët kontribuues dhe objektivat për hartimin e SVPQ. Por ky ligj nuk arrin të vendosë parime partneriteti mes institucioneve vendore. Një hap përpara drejt një roli më aktiv të aktorëve të tjerë vendorë përshkruhet në Nenin 74 të Rregullores së Policisë së Shtetit,<sup>11</sup> (në zbatim të Ligjit për Policinë e Shtetit, Nr. 108, datë 31.07.2014), ku kërkohet një vlerësim i hollësishëm i “realizimit” të strategjisë vendore dhe planit për veprimet përkatëse. Gjithsesi, të dy versionet e ligjit për Policinë e Shtetit (ligji i vitit 2007 dhe ai i vitit 2014) humbasin qartësinë për raportet e bashkëpunimit të policisë me qeverisjen vendore.

Bashkëpunimet e tjera ndëraktorale midis institucioneve në nivel vendor janë rregulluar përmes akteve nënligjore. Këtu radhiten bashkëpunimet midis ministrive përkatëse për rritjen e bashkëpunimit për sigurinë në shkolla apo ajo e Ministrisë të Rendit Publik dhe Ministrisë të Pushtetit Vendor në vitin 2002. Ky akt, krahas të tjerash, normonte një herë në gjashtë muaj

raportimin e shefit të komisariatit dhe drejtorit të policisë së qarkut për gjendjen e kriminalitetit pranë këshillit bashkiak apo këshillit të qarkut.

Një akt tjetër normativ është Urdhri Nr. 407, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për planifikimin dhe organizimin e shërbimeve të komisariateve të policisë mbi bazën e zonës policore”, urdhër që kërkon një qasje të integruar të shërbimeve policore në zonë. Megjithëse ende nuk ka evidenca publike për efikasitetin e saj. Sigurimi i zonave të policimit, veçanërisht në zonat urbane, do të ishte shumë më rezultativ, nëse qeverisja vendore do t’i përgjigjej me struktura përfaqësuese komunitare. Në fakt, nenet 68 dhe 69 të Ligjit “Për Vetëqeverisjen Vendore” e kanë të parashtruar ngritjen e këshillit komunitar të mini-zonës urbane dhe ndërlidhësin përkatës të komunitetit. Zbatimi i këtyre kërkesave të ligjit nga qeverisja vendore është instrument mjaft i rëndësishëm për fuqizimin e qytetarëve dhe të partneritetit me ta.

Novacioni më i rëndësishëm “trekëndëshit” është përfshirja e institucionit të Prokurorisë. Roli i saj në këtë partneritet vendor është i veçantë, një risi që bazohet në dokumentin e saj strategjik:

“...përveç funksionit të saj parësor në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës organizon dhe bashkëpunon me institucione shtetërore si dhe me subjekte të tjera publike e private në veprimtari për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit”<sup>12</sup>

••••

12 Prokuroria e Përgjithshme, Strategjia Afatmesme 2018-2020 dhe Plani i Veprimit, 2018, fq. 15, [http://www.pp.gov.al/web/strategjia\\_pp\\_2018\\_2020\\_final\\_1357.pdf](http://www.pp.gov.al/web/strategjia_pp_2018_2020_final_1357.pdf).

13 Takimet e llogaridhënjes publike u mbajtën në Berat, Pogradec, Kurbin, Korçë, Peshkopi, Mat, Shkodër, Lushnje, Kavajë, Dropull, Selenicë, Librazhd, Njësitë Administrative Nr 5 dhe 7 në Tiranë, dhe Kamzë

Masat në këtë drejtim fokusohen, ndër të tjera, kryesisht në: informimin e publikut dhe medias në menyre të vecante për statistikën e krimit; fushata ndërgjegjësuese për fenomenet kriminale që shfaqin tendencat më shqetësuese, apo çështje të tjera që vlerësohen të rëndësishme nga zyra e prokurorisë vendore, etj.

## “TREKËNDËSHI” POLICI-BASHKI-PROKURORI NË TAKIMET PUBLIKE LLOGARIDHËNËSE

Gjatë periudhës nëntor 2018 dhe maj 2019, u organizuan takime publike llogaridhënëse nga institucionet vendore dhe përgjithësisht nga bashkitë<sup>13</sup> me pjesëmarrjen e këshilltarëve, administratorëve, kryetarëve të fshatrave, drejtuesve vendorë të arsimit, bordet e nxënësve dhe prindërve, organizata joqeveritare dhe qytetarë të interesuar.

“Mbështetja njëzëri nga krerët vendorë të institucioneve të policisë, bashkisë dhe prokurorisë tregon se kjo platformë komunikimi me qytetarët ofron një mundësi hapjeje të institucioneve për përmirësimin e imazhit dhe besueshmërisë publike të tyre. Përvoja nxit premisa për një punë më të koordinuar të institucioneve në nivel vendor duke hartuar plane ndërhyrjeje të përbashkëta për parandalimin e krimit. Në një plan perspektive, ky bashkëpunim vendor mund të shërbejë si një bazë e mirë për një ndërhyrje në kuadër të parandalimit të krimit

*të organizuar përmes një qasje administrative.<sup>14</sup>*

---

Në buletinet “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet” dhe në botime të tjera të IDM-së këto takime janë pasqyruar më të plota. Në to jepet një panoramë e detajuar të çështjeve që janë ngritur në këto takime. Kështu, në këtë analizë do sillen disa nga shembujt që mund të përbëjnë prirje për institucionet vendore për përmirësimin e ndjeshëm të punëve në përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve për rend dhe siguri publike në të ardhmen.

Gjatë takimit llogaridhënës në Shkodër, me nismën e kryetares së bashkisë dhe drejtorit të policisë, u ra dakord për të diskutuar me drejtuesit e arsimit dhe shkollave. Gjatë komunikimit me qytetarët, bashkia shprehu dëshirën për të realizuar një vlerësim realist të situatës së përdorimit të bimëve narkotike në shkolla me qëllim investimin për parandalimin e kësaj dukurie.<sup>15</sup>

“*Në Peshkopi, një këshilltar bashkiak i kërkoi drejtueseve të institucioneve të përmirësojnë komunikimin me qytetarët dhe t'i informojnë rregullisht ata për gjendjen e kriminalitetit. Në të njëjtin takim, një përfaqësues i shoqërisë civile deklaroi*

*se pavarësisht arritjeve që prezantohen nga institucionet, vërehen “shumë probleme që mbeten të nxehta dhe me ndikim negativ në jetën e njerëzve, sidomos të rinjve; si dhuna dhe përdorimi i substancave narkotike”. Sipas tyre “kjo do të thotë se gjërat nuk janë zgjidhur si duhet, prandaj diskutimi dhe gjetja e zgjidhjeve dhe angazhimi i përbashkët duhet të bëhet një praktikë pune e vazhdueshme e të gjitha institucioneve.”<sup>16</sup>*

---

Në Bashkinë Selenicë janë sjellë shqetësime konkrete për çështje të kultivimit të bimëve narkotike.<sup>17</sup> Shoqëria civile dhe drejtuesit e arsimit në takimin llogaridhënës në Bashkinë Pogradec ishin mjaft kërkues ndaj institucioneve për sa i përket parandalimit të përdorimit të drogës dhe çështje të tjera të zbatimit të ligjit, ndërsa shefi i komisariatit të policisë, i pranishëm në këtë takim, u bëri thirrje qytetarëve për të bërë një vlerësim kritik të punës së policisë dhe institucioneve të tjera.<sup>18</sup> Me entuziazëm u prit kjo praktikë edhe në Bashkinë Dropull. Përfaqësues të komunitetit aty jo vetëm mbështetën takimet llogaridhënëse të tre institucioneve, duke u shprehur se “realizimi periodik i tyre shmang tensione të ndryshme” (duke i bërë referencë të nënkuptuar edhe ngjarjeve të Bularatit të

••••

- 14 Parandalimi i krimit të organizuar kërkon një qasje të integruar në fushat e kriminalistikës, si dhe ato fiskale dhe administrative. Bashkitë, policia, shërbimi i prokurorisë publike dhe administrata e taksave punojnë së bashku në kuadër të zbatimit të një marreveshje administrative mbi një qasje të integruar kundër krimit të organizuar. Më shumë për modelin hollandez në adresën: <https://www.riec.nl/maatregelen-en-documenten/handboek-bestaurlijke-aanpak-georganiseerde-criminaliteit>
- 15 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 2 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2019, fq. 7, <http://idmalbania.org/download/5875/>
- 16 Po aty, fq. 9.
- 17 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 3 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2019, fq. 6, <http://idmalbania.org/download/6387>
- 18 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 3 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2019, fq. 6, <http://idmalbania.org/download/5684/>



disa muajve më parë).<sup>19</sup>

“*Drejtuesja e Prokurorisë Korçë, duke vlerësuar takimin, tha se “ky lloj takimi i hapur do t’i shërbejë thirrjes për një bashkëpunim më të madh të publikut me prokurorinë.”<sup>20</sup> Të njëjtin mendim shprehu edhe Prokurorja e Pogradecit, Dorina Bejko, e cila theksoi se këto takime janë të rëndësishme për të fituar besimin publik nga institucionet ligj-zbatuese vendore dhe për rritjen e përgjegjshmërisë së tyre. Aktivitete të tilla janë nxitje për qytetarët “për të qenë më aktiv në procesin parandalues dhe denoncimin e shkelësve të ligjit”.<sup>21</sup> Në të njëjtën linjë, Prokurori i Kavajës theksoi nevojën e institucionalizimit të një kulture llogaridhënieje, të drejtpërdrejtë, jo vetëm në formën shkresore ligjore, por dhe përmes përgjegjësisë komunitare. Ai theksoi se “kjo arrihet duke organizuar periodikisht këto forma takimesh, duke e formalizuar dhe nëpërmjet një marrëveshje mirëkuptimi ose bashkëpunimi.”<sup>22</sup>*

Takimet llogaridhëne dëshmojnë se janë shumë të rëndësishme për institucionin e kryetarit të bashkisë, por edhe të Këshillit Bashkiak, sepse sjellin ndjeshmëri konkrete për përgjegjësinë e tyre në sigurinë publike. Një pjesë

e konsiderueshme e problematikës së sigurisë lidhet me kompetencat e qeverisjes vendore (ndriçimi, sinjalistika rrugore, ndotja akustike, etj.). Nga ana tjetër, institucioni i bashkisë, duke qenë menaxhues i fondeve publike mund, dhe duhet, të mbështesë prioritetet e caktuara të sigurisë vendore. Bashkia Shkodër ofron një shembull tipik (dhe klasik) për policimin në komunitet. Për të parandaluar krimin dhe për rritjen e sigurisë në qytet, bashkia instaloi kamera të sigurisë në pikat e “nxehta” të qytetit. Ky bashkëpunim mes bashkisë dhe Policisë së Shtetit përbën një shembull të zbatimit të praktikës së mirë, gjë që evidentohet në literaturën e huaj për policimin në komunitet.<sup>23</sup>

## SHEMBUJ NGA PËRVOJA E VENDEVE TË RAJONIT

Perspektivat e përshkruara më sipër në lidhje me përvojat e ndryshme vendore janë në rezonancë me zhvillimet në vendet e Ballkanit Perëndimor. Një studim i Qendrës së Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP) për vlerësimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë në Serbi shkruan se në vitin 2007, në Serbi, 45% e bashkive kishin ngritur këshillin e sigurisë, por “rezultatet e punës së tyre linin për të dëshiruar”.<sup>24</sup> Studimi mbi rolin e KVS 10 vjet pas krijimit të tyre në Serbi vëren se është shpenzuar shumë kohë për krijimin dhe përcaktimin e bazës rregullatore të tyre, por ajo që

••••

19 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 1 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2018, fq. 5, <http://idmalbania.org/download/5875/>

20 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 2 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2019, fq. 10, <http://idmalbania.org/download/5684/>

21 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 1 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2018, fq. 8-10, <http://idmalbania.org/download/5684/>

22 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr. 2 “Integritet-Llogaridhënie-Partneritet”, 2019, fq. 13, <http://idmalbania.org/download/5875/>

23 Po aty, fq. 7, <http://idmalbania.org/download/5875/>

24 Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë. “Partneritet për Komunitete të Sigurta në Serbi (Partnership for Safe Communities in Serbia), 2014, [http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership\\_for\\_safe\\_communities.pdf](http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership_for_safe_communities.pdf)

ka munguar gjatë kësaj periudhe është “operacionalizimi i punës së këtyre strukturave”.<sup>25</sup>

“ Në Kosovë, Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSB) janë ngritur që në vitin 2009, me një sërë kompetencash thuajse në të gjitha komunat e Kosovës. Por ashtu si në Serbi, edhe në Kosovë një raport monitorimi të ndërmarrë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë mbi efikasitetin e tyre ndër tre gjetjet kryesore janë: mungesa e vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve në nivelin vendor; KKSB-të janë themeluar në shumicën e komunave, por ato nuk funksionojnë gjithmonë; shumicës së KKSB-ve u mungon përfshirja e qytetarëve.”<sup>26</sup>

Takimet publike të llogaridhënies nxisin bashkëpunimin për më shumë forma komunikimi. Në Shqipëri, ashtu si dhe në vende të tjera të rajonit, përvoja tregon se kur drejtuesit vendorë të bashkisë dhe të policisë flasin për bashkëpunim të mirë ata kanë parasysh raportet personale dhe takimet mes drejtuesve.

“ E njëjta situatë përshkruhet dhe në raportin e organizatës BCSP për bashkëpunimin në Serbi ku sipas gjetjeve të tyre “komunikimi midis institucionit të qeverisjes vendore dhe policisë varet shumë nga cilësia e marrëdhënieve personale mes kryetarit të bashkisë dhe drejtuesit të njësisë së policisë në nivel vendor”.<sup>27</sup> Edhe pse kjo pasqyron realitetin në rajon, ku raportet personale të drejtuesve kanë rëndësi, i duhet kushtuar vëmendja e duhur komunikimit institucional dhe të rregullt të Policisë së Shtetit me këshillin bashkiak.

Sipas praktikës së takimeve llogaridhëse, edhe strategjitë vendore të policimit në komunitet duhet të marrin një pamje më konkrete, më të lidhur me qytetarët dhe komunitetet vendore. Strategjia në nivel qarku nuk duhet të jetë gjë tjetër veçse një përmbledhje e strategjive të hartuara dhe zbatuar mbi bazë komisarati.



25 Po aty.

26 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Vlerësimi i Mbikëqyrjes Demokratike dhe Mekanizmave të Qeverisjes së Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, 2010, fq. 4, [http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi\\_i\\_Mbik%C3%ABqyrjes\\_Demokratike\\_dhe\\_Mekanizmavet%C3%AB\\_Qeverisjes\\_s%C3%AB\\_K%C3%ABshillave\\_Komunale\\_p%C3%ABr\\_Siguri\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_\(alb\\_eng\\_srb\)\\_809361.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_Mbik%C3%ABqyrjes_Demokratike_dhe_Mekanizmavet%C3%AB_Qeverisjes_s%C3%AB_K%C3%ABshillave_Komunale_p%C3%ABr_Siguri_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_(alb_eng_srb)_809361.pdf)

27 25 Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë. “Partnership për Komunitete të Sigurta në Serbi (Partnership for Safe Communities in Serbia), 2014, fq. 20, [http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership\\_for\\_safe\\_communities.pdf](http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership_for_safe_communities.pdf)

# PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit kanë mbështetur një sërë nismash për promovimin e policimit në komunitet. Megjithatë, sfidat e sigurisë qëndrojnë dukshëm përtej kapaciteteve aktuale të institucionit. Është e vështirë që këto sfida të trajtohen vetëm me metoda tradicionale me ndërhyrje vertikale të institucioneve të zbatimit të ligjit. Përvojat e deritanishme nuk po çojnë në rezultate të qarta dhe të qëndrueshme të këtyre ndërhyrjeve. Policia e Shtetit duhet të brendësojë nevojën për investim të vazhdueshëm në ndërtimin e partneriteteve, të cilat nuk mund të realizohen vetëm me ndërhyrje të pjesshme nga jashtë, përfshi këtu edhe kontributet e organizatave të ndryshme vendase apo të huaja. Janë mjaft të nevojshme ndërhyrje që të ndryshojnë mendësinë shoqërore drejt bashkëpunimit dhe mentalitetin e policimit drejt partneriteteve horizontale, drejt hapjes, dhe përgjegjshmërisë ndaj nevojave për rend dhe siguri.

Takimet publike të llogaridhënies janë të vetmet instrumente gjithëpërfshirës që mbështeten në filozofinë e partneritetit dhe njëherazi ofrojnë një qasje nga poshtë-lart përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Një llogaridhënie e tillë nxit debatin në nivel vendor për sigurinë, që nga ana e saj ndikon në ndryshimin e mentalitetit shoqëror mbi përgjegjësinë e përbashkët dhe bashkëpunimin mes institucioneve dhe qytetarëve.

Pikënisja për çdo përmirësim, nëse do i referoheshim përvojës së tri dekadave të fundit, mbetet Ligji i Policisë së Shtetit i vitit 1999, në të cilin ruhet karakteri unitar i policisë dhe orientohet përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe bashkëpunimi

horizontal i policisë me qeverisjen vendore dhe komunitetin.

Ashtu siç nënvizohet në Strategjinë e Rendit Publik 2015-2020, “ndryshimi i menaxhimit të punëve dhe bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë”<sup>28</sup> kërkon njëherazi përmirësimin dhe përshtatjen e bazës ligjore dhe rregullatore të institucioneve, veçanërisht të Policisë së Shtetit dhe të qeverisjes vendore për rritjen e bashkëpunimit dhe përgjegjshmërisë institucionale. Ndërkohë, Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” ka nevojë për një rivlerësim të kompetencave dhe detyrimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak për menaxhimin e sigurisë publike, një pjesë e të cilave mund të trajtohen edhe përmes Këshillit Vendor të Sigurisë Publike.

Për të ndërtuar një kornizë që mundëson një qasje të qëndrueshme partneriteti dhe qeverisje funksionale dhe efektive, në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, IDM propozon vlerësimin e këtyre rekomandimeve:

- Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme të miratojnë një marrëveshje për **mbajtjen periodike të takimeve tripalëshe llogaridhënese**, të bien dakord për qëllimin dhe modalitete të tjera organizative të tyre.
- Mbështetur në praktikën e sipërcituar të Ligjit të Policisë së Shtetit të vitit 1999, roli i këshillit bashkiak në dhënie e pëlqimit (apo argumentimin) **për emërimin e drejtuesit vendor të policisë dhe vlerësimi periodik i punës nga ana e këtij këshilli** mbeten

••••

28 Strategjia e Rendit Publik 2015-2020

hapat më të rëndësishëm në rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe bashkëpunimit të policisë me qeverisjen vendore.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të monitorojë procedurat e hartimit dhe zbatimit të Strategjive Vendore të Policimit si dhe vlerësimit të ndikimit të tyre. Hartimi i këtyre strategjive **të kalojë në bazë komisarati. Pronësia vendore** e të gjithë aktorëve të përfshirë në SVP(Q) është **kusht themelor** në suksesin e procesit. Një raport kombëtar vlerësimi

i pavarur mbi bazë vjetore mbi cilësinë e përmbushjes së këtyre kërkesave të ligjit do të ndikonte në qëndrime proaktive të institucioneve drejt partneriteteve vendore.

- Ngritja në të gjithë vendin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) duhet të mbetet **një prioritet** dhe të shoqërohet me procese që ndihmojnë **operacionalizimin e kësaj strukture**. Takimet llogaridhënëse vendore janë instrumente për të jetësuar punën e KVSP dhe përditësuar objektivat e SVP(Q).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nr. \_\_\_\_ Prot.  
Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

Nr. \_\_\_\_ Prot.  
Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

Nr. \_\_\_\_ Prot.  
Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME  
TË POLICISË SË SHTETIT**

### **PËR MBAJTJEN E TAKIMEVE LLOGARIDHËNËSE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT NË NIVEL VENDOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17/12/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 108/2014, datë 31/07/2014, "Për Policinë e Shtetit", të Ligjit Nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të Strategjisë afatmesme 2018-2020 të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 702, datë 26/08/2015, "Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015-2020 dhe të Planit të Veprimit 2015-2017".

Nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi në funksion të bashkërendimit të punës ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, si përfaqësues të drejtpërdrejtë të komuniteteve vendore dhe me detyrime të drejtpërdrejta ligjore për shërbime ndaj qytetarëve, Policisë së Shtetit në nivel vendor dhe prokurorive të rretheve gjyqësore. Palët, duke vlerësuar praktikën e takimeve llogaridhënese në parandalimin e krimit, në përmirësimin e sigurisë publike dhe mirëqeverisjes, bien dakord si më poshtë vijon:

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi i Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje ka për qëllim të nxisë ndërveprimin e institucioneve me qytetarët dhe komunitetet vendore për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështje të kriminalitetit në nivel vendor,

për të përmirësuar edukimin ligjor si dhe për të fuqizuar shërbimet në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

## **Neni 2**

### **Objekti i Marrëveshjes**

Objekti i kësaj marrëveshje janë vendosja e bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet bashkive, Policisë së Shtetit në nivel vendor dhe prokurorive të rretheve gjyqësore si dhe realizimi periodik të takimeve trepalëshe llogaridhënëse për parandalimin e krimit në nivel vendor.

## **Neni 3**

### **Përgjegjësitë e zbatimit**

1. Ministria e Brendshme, përmes Agjencisë së Mbështetjes për Vetëqeverisjen Vendore, merr përsipër:
  - a) Të mbështesë njësitë e vetëqeverisjes vendore për angazhim institucional të tyre në organizimin e takimeve llogaridhënëse vendore;
  - b) Të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të Këshillave Vendorë të Sigurisë dhe aktivitetin gjithëvjetor të tyre.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet drejtorive vendore dhe komisariateve të policisë, merr përsipër:
  - a) Të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve vendorë të Policisë së Shtetit në takimet llogaridhënëse trepalëshe në nivel vendor, në nivel drejtuesi vendor dhe shefa sektorësh;
  - b) Të reflektojë komunikimet me grupet e interesit në takimet llogaridhënëse në Plan Veprimin vjetor në zbatim të strategjisë vendore të sigurisë publike në nivel komisarati.
3. Prokuroria e Përgjithshme merr përsipër të koordinojë me prokuroritë e rretheve gjyqësore për angazhimin e tyre institucional në zhvillimin e takimeve llogaridhënëse trepalëshe në nivel vendor dhe të mbështesë mbarëvajtjen e tyre.

## **Neni 4**

### **Realizimi i Takimeve**

1. Takimet llogaridhënëse organizohen nga bashkia si kryesuese e këshillave vendorë të sigurisë, duke bashkëpunuar me institucionet e varësisë, komisaritet e policisë dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore.
2. Si rregull, takimet llogaridhënëse në nivel vendor udhëhiqen nga përfaqësuesit më të lartë të Bashkisë, Komisaritatit vendor dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.
3. Takimet duhet të jenë sa më gjithëpërfshirës dhe me përfaqësim të institucioneve vendore dhe komuniteteve qytetare.
4. Në takimet llogaridhënëse ftohen të gjithë aktorët e tjerë të interesuar, komunitetet e shkollave (mësues, prindër, nxënës), përfaqësues të biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Bëhen përpjekje që këto takime të jenë sa më të hapura ndaj publikut.
5. Ecuria e punës së takimeve llogaridhënëse ndiqet dhe mbështetet nga Këshilli Vendor i Sigurisë, i cili përgatit raportin vjetor të ecurisë së takimeve llogaridhënëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të institucioneve të nivelit vendor.

#### **Neni 5**

##### **Shpeshhtësia e Takimeve**

1. Takimet llogaridhëse trepalëshe në nivel vendor realizohen si rregull dy herë në vit.
2. Në varësi të problematikave apo emergjencave të ndryshme, me dakordësinë e palëve mund të mbahen takime të posaçme. Secila nga palët ka të drejtën për të ndërmarrë një takim llogaridhëses.

#### **Neni 6**

##### **Shkëmbimi i Informacionit**

1. Palët shkëmbejnë informacion dhe rekomandime që dakortësohen nga takimet dhe procesin e punës për zbatimin e tyre. Në këtë komunikim mund të përfshihen edhe institucione të tjera sipas problematikës.
2. Komunikimi si rregull kryhet në rrugë shkresore ose elektronike.

#### **Neni 7**

##### **Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Marrëveshja lidhet për një periudhë kohore të papërcaktuar nga dita e nënshkrimit të saj dhe do të jetë efektive në vazhdimësi.

#### **Neni 8**

##### **Personat e kontaktit**

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, në formë shkresore apo elektronike. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palët e tjera nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

#### **Neni 9**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### **Neni 10**

##### **Dispozita të fundit**

- a. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6 të saj.
- b. Marrëveshja mund të rishikohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të tre Palët.
- c. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 6 (gjashtë) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**POLICI**

**BASHKI**

**PROKURORI**

**INTEGRITET**



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands